

KPMG Albania Sh.p.k. - Kosovo Branch
Sulejman Vokshi, No. 14
Pristina
Kosovo

Telephone +381 38 246 771
Telefax +381 38 246 772
E-mail al-kosovo@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË KOMUNËS SË
KAÇANIKUT PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2011

Ky përkthim është vetëm për qëllime informimi. Varianti anglisht i cili është edhe origjinali ka prioritet mbi të.

Prishtinë, Qershor 2012

TABELA E PËRMBAJTJES

I.	Përmbledhje e përgjithshme	3
II.	Hyrje.....	4
III.	Opinionit i auditimit	6
IV.	Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara	9
V.	Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar	10
VI.	Pasqyrat financiare	11
VI.1	Pajtueshmëri me kornizën raportuese dhe cilësia e informacionit	11
VI.2	Të hyrat (duke përfshirë ato vetanake).....	12
VI.3	Shpenzimet	13
VI.4	Subvencionet dhe transferet.....	14
VI.5	Pasuritë dhe Borxhet.....	14
VII.	Kontrolli i menaxhmentit	17
VII.1	Sistemet e Kontrollit të Brendshëm.....	17
VII.2	Komiteti i Auditimit	17
VIII.	Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhimin e Komunës së Kaçanikut.....	18
Shtojca 1.	Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit të bazuara në ISSAI 4000.....	19
Shtojca 2:	Rekomandimet e vitit të mëhershëm.....	21
Shtojca 3.	Komentet e Menaxhmentit të Komunës së Kaçanikut dhe përgjigjja e KPMG-së	22

I. Përmbledhje e përgjithshme

KPMG ka kryer auditimin e pasqyrave vjetore financiare ("PVF") të Komunës së Kaçanikut ("Komuna"), në emër të Zyrës së Auditorit Gjenaral të Kosovës, për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, të hartuara nga Organizata Ndërkombëtare e Instruksioneve Supreme të Auditimit (ONISA) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Me poshtë gjeni një ekstrakt të marrë nga opinionimi i auditimit në faqen 9 të këtij dokumenti:

"Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë në të gjitha aspektet material, te pagesave dhe pranimeve për vitin 31 Dhjetor 2011 në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik Bazuar në Paranë e Gatshme ('SNKSP') Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme dhe me Rregullwn Financiare Nr. 07/2011 Raportimi Vjetor i Organizatave Buxhetore."

Kontrolli i brendshëm

Auditimi ynë ka gjetur mangësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Këto mangësi janë shpjeguar në detaje në brendësi të raportit.

Konkluzioni ynë është që sistemi i kontrolleve të brendshme të Komunës nuk është dizajnuar në mënyrë të duhur për eliminim e dobësive evidente dhe nuk është implementuar në mënyrë të duhur.

Me qëllim që të përmirësohet funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrolleve të brendshme, ne i rekomandojmë Komunës që të sigurohet që:

- Të mbahet një sistem automatik i faturimit për të gjitha llojet e taksave;
- Të bëhet barazimi i të hyrave në mes zyrtarit të të hyrave vetanake dhe departamenteve operacionale;
- Të merren masa për rritur mbledhjen e të hyrave nga taksa të ndryshme; dhe
- Ligjet Nr. 03/L-241 dhe 04/L-042 'Ligji i prokurimit publik në Kosovë' (i ndryshuar), që të dy të aplikueshëm në periudha të ndryshme të vitit 2011, të ndiqen në tërësi; dhe

Menaxhmentit të Komunës i është dhënë mundësia për të bërë komente mbi gjetjet e prezantuara në këtë raport. Menaxhmenti është pajtuar pjesërisht për të bërë të gjitha përpjekjet për të adresuar rekomandimet tona.

Referohuni në Shtojcën 3 për komentet e menaxhmentit ndaj rekomandimeve tona dhe përgjigjen tonë ndaj tyre.

II. Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011.

Është përgjegjësi e Komunës së Kaçanikut që të përgatisë pasqyrat vjetore financiare sipas kërkesave të Rregullës Financiare 07/2011 dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”.

KPMG në emër të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, është përgjegjëse për kryerjen e auditimit vjetor për pasqyrat financiare të Komunës më dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2011.

Auditimi është një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare si dhe dhënien e sigurisë në lidhje me:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për ndonjë çështje tjetër të rëndësishme të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Kemi kryer një vlerësim preliminar të Komunës. Gjatë këtij vlerësimi, kemi adresuar nëse Komuna i ka trajtuar rekomandimet e mëparshme si dhe cilësinë e pasqyrave financiare preliminare. Bazuar në këtë ne kemi këshilluar menaxhmetin. Rekomandimet tona po ashtu përfshijnë edhe këshillat e dhëna në lidhje me përmirësimet që duhen bërë që pasqyrat financiare të jenë në përputhje me Rregullën Financiare 07/2011 dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) për “Raportimin financiar sipas kontabilitetit në baza të parasë së gatshme”. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë tona për auditimin e Komunës, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi krahasuar pasqyrat vjetore financiare të Komunës me buxhetin e miratuar për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2011;
- Kemi përcaktuar nëse pasqyrat vjetore financiare të Komunës janë përgatitur në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe Rregullën Financiare nr 07/2011;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të të hyrave dhe shpenzimeve, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi kryer testimet substanciale mbi transaksionet financiare; dhe
- Jemi mbështetur në një kombinim të intervistave, rishikimeve analitike, kontrollimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;

Në këtë raport ne përmbledhim gjetjet e auditimit e këtij viti dhe japim opinionin tonë mbi Pasqyrat Vjetore Financiare më dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2011.

ONISA ka vendosur kritere specifike që përcaktojnë llojin e opinionit që duhet te jepet sa i përket opinionit të auditimit në lidhje me pasqyrat financiare vjetore të Komunës.

Këto janë të sqaruara më gjerësisht në Shtojcën 2, e cila përmban një ekstrakt nga ISSAI 4000.

III. Opinioni i auditimit

Për Komunën e Kaçanikut

Prishtinë, 25 Qershor 2012

Ne jemi angazhuar për të audituar pasqyrat financiare përcjellëse të Komunës së Kaçanikut ("Komuna"), që përbëhen nga pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2011, një krahasim të shumave të buxhetuara dhe ato aktuale, dhe një përmbledhje të politikave kyçe kontabël dhe shenimeve të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Menaxhimit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik Bazuar në Paranë e Gatshme ('SNKSP') – *Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme* dhe me Rregullën Financiare Nr. 07/2011 *Raportimi Vjetor i Organizatave Buxhetore*. Kjo përgjegjësi përfshin: zbatimin dhe mbajtjen e një kontrolli të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Në kemi kryer auditimin tonë në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, të hartuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA). Këto standarde kërkojnë që ne të jemi në përputhje me kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të mbledhur siguri të arsyeshme në lidhje me, nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi të auditimit për shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi jonë, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, ne i konsiderojmë kontrollet e brendshme të entitetit në lidhje me përgatitjen e dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë së evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë në të gjitha aspektet material, të pagesave dhe pranimeve për vitin 31 Dhjetor 2011 në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik Bazuar në Paranë e Gatshme ('SNKSP') *Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme* dhe me Rregullën financiare Nr. 07/2011 *Raportimi Vjetor i Organizatave Buxhetore*.

Theksim i qështjes

Pa kualifikuar opinionin tonë, ne tërheqim vëmendjen si në vijim:

Sikurse është shpalosur në shenimin 30, Komuna ka tentuar që të matë këta artikuj me vlerën e tregut në bazë të një vlerësimi të kryer nga një komision i themeluar brenda Komunës. Komisioni nuk është i përbërë nga vlerësues ekspert dhe vlerat e raportuara në pasqyrat financiare nuk janë të mbështetur nga ndonjë raport të vlerësimit.

Rishikimi i përputhshmërisë

Përveç auditimit të pasqyrave financiare, është planifikuar dhe kryer një rishikim i përputhshmërisë për të shprehur një konkluzion me siguri të kufizuar nëse në të gjithë aspektet materiale, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje me autoritetet që i qëverisin ato. Natyra, koha dhe masa e punës për përputhshmërinë ishin të kufizuara krahasuar me atë të hartuar për të shprehur një opinion me siguri të arsyeshme për pasqyrat financiare.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një konkluzion bazuar në rishikimin tonë. Puna jonë është kryer në përputhje me ISSAI 4200 *Udhëzime mbi Auditimin e Përputhshmërisë Lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Këto parime kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë rishikimin për të arritur një siguri të kufizuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje, në të gjitha aspektet materiale me autoritetet që i qëverisin ato.

Një rishikim është i kufizuar kryesisht në procedura analitike dhe intervista, dhe për këtë jep më pak siguri së një auditim. Ne nuk kemi kryer një auditim, dhe për këtë arsye, ne shprehim konkluzionin tonë në formën e një sigurie të kufizuar, e cila është konsistente me punën e kufizuar që ne kemi kryer për këtë rishikim përputhshmërie.

Ne besojmë së evidenca që ne kemi marrë është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për të dhënë një bazë për konkluzionet tona.

Konkluzion për Përputhshmërinë

Bazuar në punën tonë të përshkruar në këtë raport, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare që kemi parë gjatë rishikimit, janë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me autoritetet që i qëverisin ato.

Çështje të tjera

Ne tërheqim vëmendjen për si më poshtë:

- 1 Burimi kryesor e i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është Free Balance. Sidoqoftë, pasi që Free Balance nuk përdoret për të regjistruar pagesat nga palët e treta dhe faturat e papaguara, ai nuk mund të përdoret vetëm për të prodhuar pasqyra financiare gjithëpërfshirëse.”

- 2 Pasiqë Komuna nuk ka implementuar një sistem faturimi automatik dhe gjithëpërfshirës, mund të ketë pasiguri në lidhje me plotësinë e të arkëtueshmeve dhe të hyrave që Komuna mund të fitojë dhe në aftësinë për të përgatitur një buxhet të besueshëm dhe të saktë, për të raportuar një raport të saktë arkëtueshmërie, dhe për të monitoruar arkëtimet e të hyrave vetanake në baza kohore.
- 3 Ne kemi identifikuar një numër mospërputhshjesh me Ligjin Nr. 04/L-042 'Ligji i Prokurimit Publik'. Mospërputhje të tilla janë të lidhura me procedurat e kërkuara të cilat Komuna nuk i ka kryer dhe dokumentuar.
- 4 Megjithëse Komuna mund të jetë e përfshirë në disa raste të vogla ligjore dhe pagesa të parasë së gatshme të mund të kërkohen në të ardhmen e afërt, Komuna nuk ka vendosur ndonjë proces formal që mund të sigurojë informacion të plotë, të përshtatshëm dhe të besueshëm për regjistrimin e provizioneve dhe detyrimeve kontigjente.

KPMG Albania Shpk Kosovo Branch

KPMG Albania Sh.p.k. – Kosovo Branch
14, Sulejman Vokshi Street
Pristina
Kosovo

IV. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara

Ne letren tonë te menaxhmentit te mëparshme për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010 janë dhënë pesë rekomandime kryesore. Tre nga rekomandimet e dhëna vitin e kaluar, përgaditja e pasqyrave financiare, shpalosja e pronave dhe krijimi i komitetit të auditimit janë zgjidhur, ndërsa dy te tjerat, të cilat janë shpalosur më poshtë mbesin për tu adresuar, domethënë:

- Ne kemi identifikuar një numër mos-pajtueshmëri në fushën e shpenzimeve, duke përfshirë mos-pajtueshmëritë me “Ligjin për Prokurimin Publik në Kosovë” Ligji Nr 04/L-042 (i ndryshuar), mos-pajtueshmëri në fushën e pagave dhe mëditjeve dhe të blerjeve tjera. Këto mos-pajtueshmëri lidhen me procedurat që kërkohen, të cilat nuk janë kryer dhe dokumentuar nga Komuna.
- Të vendoset një sistem faturimi për të gjitha llojet e taksave dhe duhet të merren masa për të ngritur mbledhjen e të hyrave nga taksa të ndryshme.

Mos adresimi i plotë i rekomandimeve tona në 2011, kanë shkaktuar të njëjtat gjetje në këto fusha sikurse në vitin 2010.

V. Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Financiare krahasuar me Buxhetin e Aprovuar tregon:

Tabela 1: Përshkrimi i buxhetit dhe shpenzimeve aktuale

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Rishikuar	Buxheti Final	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Të hyrat vetanake	567,000	-	585,000	510,000	515,000
Donacionet e vendit	-	-	79,000	79,000	-
Donacionet e jashtme	-	-	-	-	22,000
I. Gjithsej të hyrat dhe transferi i donacioneve	567,000	-	664,000	589,000	537,000
Rrogat dhe pagat	3,502,000	-	3,567,000	3,557,000	2,769,000
Mallra dhe shërbime	364,000	-	470,000	433,000	454,000
Shpenzimet komunale	82,000	-	87,000	87,000	87,000
Subvencionet dhe transferet	42,000	-	82,000	73,000	61,000
Investimet Kapitale	1,471,000	-	1,610,000	1,443,000	1,033,000
Rezervat	-	-	-	-	-
II. Gjithsej shpenzimet	5,461,000	-	5,816,000	5,593,000	4,404,000
Ndryshimi I-II	(4,894)	-	(5,172)	(5,004)	(3,867)

Shumat e buxhetuara janë ekstraktuar nga nenet e më poshtme të pasqyrave financiare për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2011: Neni 13 –Raporti i ekzekutimit të buxhetit.

Konkluzion

Total të ardhurat aktuale dhe transferet e donacioneve ishin më të ulëta se buxheti final për EUR 75 mijë për shkak të realizimit të të hyrave vetanake të cilat ishin më të ulëta për një shumë prej EUR 75 mijë.

Dalja aktuale e paras së gatshme nga llogaria e thesarit ishte më e ulët se buxheti final për një shumë prej EUR 223 mijë, për shkak të Pagave dhe Mëditjeve që ishin më të ulëta për EUR 10 mijë, mallëra dhe shërbime që ishin më të ulëta për EUR 37 mijë, për shkak të transfereve dhe subvencioneve që ishin më të ulëta për EUR 9 mijë dhe shpenzimet kapitale që ishin më të ulëta për EUR 167 mijë.

Buxheti fillestar ishte më i ulët për EUR 97 mijë nga buxheti përfundimtar për shkak të parashikimeve më të ulëta për: të hyrat vetanake dhe donacionet. Të gjitha ndryshimet në buxhetin fillestar janë miratuar siç duhet nga Kryetari dhe Kuvendi Komunal. Këto ndryshime janë mbështetur edhe nga vendimi kuvendit dhe janë të lejuara nga korniza ligjore ligji 03/L-048.

Buxheti i pashpenuar i Komunës në vitin 2011 ishte me pak se 2%.

VI. Pasqyrat financiare

VI.1 Pajtueshmëri me kornizën raportuese dhe cilësia e informacionit

Bazuar në kërkesat e LMFPP Nr. 03/L-048 dhe Rregullën Financiare 07/2011.

- Komuna nuk ka përgatitur pasqyrat financiare në pajtueshmëri me Rregullën Financiare Nr. 07/2011;
- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar i entitetit të audituar;
- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar brenda kornizës kohore me datën 29 Janar 2012 dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave (“MF”);
- Pasqyrat Financiare janë dorëzuar në gjuhën shqipe dhe serbe; dhe
- Komuna ka përgatitur dhe ka dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek MF gjatë vitit 2011.

VI.2 Të hyrat (duke përfshirë ato vetanake)

Të Gjeturat

- *Sistemi i faturimit.* Një sistem automatik i faturimit ekziston vetëm për tatimin në pronë. Komuna nuk mban regjistra të faturimit për llojet tjera të të hyrave. Për këto të hyra regjistrohen vetëm arkëtimet e parave të gatshme.
- *Mbledhja e të hyrave.* Përveç tatimit mbi pronën, Menaxhmenti i Komunës nuk mban regjistra të ndarë ose ndonjë listë të të gjithë debitorëve sipas llojeve të ndryshme të taksave. Pa të dhëna të detajuara, të sakta dhe të mjaftueshme të debitorëve, Komuna nuk është në gjendje të përgatisë një buxhet të saktë dhe të besueshëm, të raportojë normën e saktë të mbledhshmërisë, dhe as të përcjellë në kohë mbledhjen e të hyrave vetanake.
- *Dobësitë në sistemin e faturimit automatik.* Sistemi i faturimit të tatimit mbi pronën është i centralizuar dhe Komuna nuk mund të rishikojë dhe monitorojë në mënyrë të duhur mbledhjen e të hyrave pasi që ajo bëhet në mënyrë automatike nga sistemi.

Rekomandimi 1

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet së Komuna do të ndërmarrë hapa për të përmirësuar sistemin e kontabilitetit dhe të faturimit në mënyrë që të sigurojë kontrolle të sigurta, efëiente dhe efektive në faturim dhe të hyra. Përmirësimi i procedurave të lidhura me këto sisteme do ti mundësonte menaxhmentit të monitoroj dhe menaxhojë rreziqet e mëdha dhe të sigurojë që vendimet në lidhje me buxhetimin, planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave janë bartur siç duhet. Ne i rekomandojmë komunës të konsideroj pikat si në vijim:

- Implementimin e një sistemi të faturimit që përfshin detaje të përditësuara për pagesit, adresën e tyre të tanishme, historinë dhe normën e mbledhjes së të hyrave nga këta pages. Qasje në informacion të tillë duhet të kenë vetëm një numër të limituar personash dhe të autorizuar nga menaxhmenti.
- Të vendosë dhe të kontrollojë nga qendra tarifat dhe normat e taksave në sistem në mënyrë që të llogarisë dhe gjenerojë automatikisht faturat. Ky gjenerim i faturave gjithashtu duhet të autorizohet dhe të rishikohet.
- Të ekzistojë një lidhje automatike në mes të sistemit të faturimit dhe sistemit të kontabilitetit në mënyrë që informacioni të procesohet automatikisht në librin kryesor të kontabilitetit.
- Të lidhen automatikisht zyra e faturimit me operacionet dhe të bëhen barazime të rregullta në mes tyre, për rastet ku faturimi direkt lidhet me shërbimet nga zyra operacionale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur ekzekutohet një numër i madh i transaksionesh.

VI.3 Shpenzimet

3.1 Blerjet përmes prokurimit

Të Gjeturat

Gjatë inspektimit tonë të dokumenteve për mostren tonë të dosjeve të prokurimit në kemi vënë re se disa mospërputhje me procedurat siç kërkohen nga Ligji për Prokurim Publik 04/L-042. Këto mospërputhje janë përshkruar më poshtë:

- Në procedurën e prokurimit KA652/11/21/521, prokurim për ndërtimin e rrugëve, kriteri për përcaktimin e fituesit ishte "çmimi ekonomikisht më i favorshëm". Në përcaktimin e ofertuesit fitues, komisioni i tenderit kishte për të marre në konsideratë parametrat në vijim: Çmimi, përvoja dhe koha. Sipas shqyrtimit tonë të dosjes së tenderit, ne kemi vërejtur se arsyeja për zgjedhjen e ofertuesit fitues, i cili kishte një çmim prej 17,370 euro më të lartë se të ofertuesit më të lirë, ishte afati kohor, në të cilën ky ofertues ka treguar një kohë të përfundimit për 15 ditë pune. Sipas mendimit tonë afati kohor i paraqitur nuk ishte i arritshëm për shkak të madhësisë dhe kompleksitetit të projektit. Natyra e këtij projekti ishte ndërtimi i një rruge dytësore 2.5 km, në terren të vështirë malor. Në të vërtetë, projekti mori tre muaj për të përfunduar nga 22 Gusht 2011 deri më 24 Nëntor 2011 dhe Komuna nuk ka aplikuar ndonjë dënim për vonesë, pavarësisht vonesave të konsiderueshme në përfundimin e projektit.
- Në procedurën e prokurimit KA652/11/006/52, prokurim për ndërtimin e rrugëve, qe ka të bëjë me punë ndërtimore, ne nuk na është ofruar plani i punëve dhe për këtë arsye nuk kemi mundur të verifikojmë nëse kishte vonesë në këtë projekt.
- Në procedurën e prokurimit KA652/11/009/521, prokurim për ndërtimin e rrugëve, buxhetimi/mjetet e zotuar për këtë projekt ishin EUR 50,000, ndërsa kontrata për projektin përkatës është në vlerën 60,926 euro.
- Për procedurën e prokurimit KA652/11/052/521, prokurim për ndërtimin e rrugëve, ne kemi vërejtur se Kontraktori nuk kishte kryer renovimin e shkollës brenda afatit kohor të miratuar. Sipas kontratës punët do duhej të përfundonin në afat prej 15 ditësh, që ishte në kohën për të filluar viti shkollor, ndesa në realitet puna ka zgjatur 3 muaj (5 Shtator 2011 deri me 15 Dhjetor 2011). Komuna nuk ka aplikuar ndonjë ndëshkim ndaj kontraktorit, përkundër që kontrata ua lejon një gjë të tillë.

Rekomandimi 2

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet që Komuna të ndërmarrë hapa të mëtijshme për përmirësimin e kontroleve mbi shpenzimet dhe pagesat dhe jetë në pajtueshmëri të plotë me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve lokale.

3.2 Blerjet tjera

Të Gjeturat

Nuk ka gjetje.

3.3 Kompenzimet (pagat dhe mëditjet)

Të Gjeturat

- Nuk ka gjetje.

VI.4 Subvencionet dhe transferet

Të Gjeturat

Nuk ka gjetje për të raportuar në këtë fushë.

VI.5 Pasuritë dhe Borxhet

5.1 Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj

Të Gjeturat

- Ne kemi vërejtur se të hyrat e grumbulluara në para të gatshme janë deponuar në bankë një herë në muaj, që nuk është në përputhshmëri me rregulloren për menaxhimin e parasë së gatshme të organizatave buxhetore. Sipas këtijë rregulli paratë e gatshme të grumbulluara duhet të depozitohen brenda 48 orëve.
- Ne kemi vërejtur se Komunës i lejohet të arkëtoje para të gatshme deri në shumë EUR 20. Kjo nuk është në përputhshmëri me rregulloren për menaxhimin e parasë së gatshme të organizatave buxhetore, i cili thotë se mund të arkëtohen mjete monetarë në vlera deri në EUR 10.
- Për më tepër, ne kemi vërejtur që Komuna ka bërë arkëtimin e të hyrave nga taksa për provimet profesionale në Shkollën Profesionale të Kacanikut, që variojnë nga EUR 100 në EUR 130. Këto shuma janë mbi limitin EUR 10 të treguar më lart, dhe si të tilla duhet të ishin arkëtuar përmes bankës.

5.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Të Gjeturat

Komuna nuk ka një process të identifikimit, evidencimit dhe percjelljes të faturave të lëshuara për taksa komunale. Kjo mund të çojë në shpalosje jo të rregullta të të arkëtueshmeve. Për më shumë, ne kemi vënë re disa të arkëtueshme, të cilat kanë mbi një vit vjetërsi.

Rekomandimi 3

Ne i rekomandojmë Kryetarit të vendosë një proces i cili siguron që të arkëtueshmet janë regjistruar sapo të jëtë bërë faturimi. Gjithashtu, regjistri i të arkëtueshmeve duhet të perditësohet sipas pagesave të bëra në lidhje me këto të arkëtueshme. Kjo do t'i mundësojë Komunës të përgatisë dhe planifikojë një buxhet më të besueshëm.

Për më tepër, ne i rekomandojmë Komunës që të rishikoj trajtimin e limitit të pranimit të parasë së gatshme.

Gjithashtu, ne i rekomandojmë Komunës që të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme mbledhjen e të arkëtueshmeve.

5.3 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale

Të Gjeturat

Për shkak të mungesës së dokumenteve mbështetës për matjen e një pjese të rëndësishme të ndërtesave, tokave dhe pajisjeve së saj të shpalosura në Shënimin 30 Komuna ka kërkuar për të matur artikuj të tillë me vlerën e drejtë në bazë të një vlerësimi të kryer nga një komitet i krijuar i brendshëm. Komisioni nuk është e përbërë prej vlerësuesve të certifikuar dhe vlerat e raportuara në pasqyrat financiare nuk janë të mbështetura nga ndonjë raport.

Rekomandimi 4

Të përfshijë burime shtesë në regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive të Komunës. Përfshirja e vlerësuesve të pavarur dhe të certifikuar është rekomanduar si praktika më e mirë në raste të tilla. Megjithatë, komuna duhet të ketë parasysh një analizë të kostos krahasuar me benefitet e përfshirjes së eksperteve vlerësues përpara se të angazhojë ata.

5.4 Borxhet

Te Gjeturat

Komuna nuk ka një process adekuat të identifikimit, evidencimit dhe percjelljes të faturave të papaguara. Kjo mund të çojë në shpalosje jo të rregullta të faturave të papaguara.

Gjithsej balanca e faturave të papaguara në fund të vitit 2011 është EUR 33 mijë. Këto detyrime janë bartur që të paguhen në vitin 2011.

Sipas ligjit nr. 03/L-048 LMFPP, Neni 39.1, cdo fature e rregullt dhe kërkesë për pagesë për mallrat dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore duhet të paguhet brenda tridhjet (30) ditëve kalendrike pas pranimit të faturës apo kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore. Ne kemi vënë re se për shumë prej faturave të papaguara kishin kaluar mbi tridhjet (30) ditë nga fundi i vitit.

Rekomandimi 5

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet së Komuna do të ndërmarrë hapa të mëtejshme për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat dhe të jetë në pajtueshmëri të plotë me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve lokale. Të gjitha përpjekjet duhet të bëhen për të bërë këto pagesa brenda vitit.

5.5 Raportimi aktual dhe afatet kohore në procesin e përgjithshëm të buxhetimit

Lidhur me përmbushjen e detyrimeve për raportim aktual të jashtëm si dhe procesin buxhetor, ne vërejtëm:

- Kërkesat buxhetore u realizuan në kohën e duhur;
- Raportet tremujore, duke përfshirë edhe pasqyrat financiare për nëntë muaj janë dorëzuar në kohën e duhur në MF.
- Poashtu draft plani i prokurimit është dorëzuar në kohën e duhur në MF;
- Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve është plotësuar në pasqyrat financiare vjetore të komunës.

Të Gjeturat

Nuk ka gjetje të tjera për tu raportuar.

VII. Kontrolli i menaxhmentit

VII.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm

Të Gjeturat

Informacion parësor në të cilin Komuna mbështetet për përgatitjen e Pasqyrave Financiare është Free Balance. Meqenëse Free Balance nuk është duke u përdorur për të regjistruar pagesat nga palët e treta, apo faturat e papaguara, nuk mund të përdoret vetëm për të prodhuar pasqyra financiare për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2011.

Rekomandimi 6

Ne i rekomandojmë Kryetarit të Komunës që përgatitja e pasqyrave financiare të Komunës duhet të përmbajë procedura dhe mjete të përcaktuara për tu siguruar që informacioni i kërkuar është regjistruar, procesuar, përmbledhur dhe raportuar drejt në pasqyrat financiare.

VII.2 Komiteti i Auditimit

Të Gjeturat

Nuk ka gjetje ne vitin 2011.

VIII. Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhimin e Komunës së Kaçanikut

Konkluzionet e përgjithshme

Siç u diskutua në këtë raport, përmirësime duhet të bëhen në fushat e të hyrave, të prokurimit, paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj, trajtimi i të arkëtueshmeve, pagimi i detyrimeve brenda afatit të kërkuar dhe vlerësimi i pasurive kapitale dhe jo kapitale.

Rekomandimi i përgjithshëm

- Duhet të vendoset një sistem automatik i faturimit për të gjitha llojet e taksave, duhet të bëhen barazimet në mes zyrtarit të të hyrave dhe departamenteve operacionle dhe duhet të merren masa për shtuar mbledhjen e të hyrave nga taksat e ndryshme, dhe
- Duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për të përmirësuar procesin e shpenzimeve.
- Duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për të paguar të gjitha faturat e papaguara brenda afateve kohore.
- Rregullorja mbi menaxhimin e parave të gatshme të organizatave buxhetore duhet të ndiqet në mënyrë të përpiktë

Shtojca 1. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit të bazuara në ISSAI 4000

- (E shkëputur nga ISSAI 4000)
- **9.** Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).
- **10. Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet
 - materiale që:
 - (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
 - (b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
 - (c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
 - (d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.
- **11. Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj së lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.
- **12.** Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:
 - (a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
 - (b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
 - (c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

- **13. Opinioni i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar.
- I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.
- **14. Opinioni i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.
- **15. Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriktionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.
- **16.** Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca 2: Rekomandimet e vitit të mëhershëm

Komponenta e Auditimit	Rekomandimi ose gjetja	Rekomandimet plotësisht të implementuara	Pjesërisht të adresuar	Të pa adresuara
Pasqyrat financiare VI.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm	Pasqyrat financiare të përgatiten sipas SNKSP dhe UA	Po		
6.3 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Krijimi i Listës së plotë të pronave, ndërtesave dhe pajisjeve të Komunës	Po		
4.1 Blerjet përmes prokurimit	Zbatimi në tërësi i Ligjit nr.2003/17 - Për Prokurimin Publik -me ndryshimet e bëra		Jane zgjidhur pjesërisht. Auditori ka patur gjetje te reja gjate auditimit per vitin 2011.	
VII.2 Komiteti i Auditimit	Themelimi i Komitetit për Auditim të Brendshëm	Po		
VI.3 Të hyrat (duke përfshirë ato vetanake)	Implementimin e një sistemi të faturimit që përfshin detaje të përditësuara për pagesit, adresën e tyre të tanishme, historinë dhe normën e mbledhjes se të hyrave, për të gjitha llojet e të hyrave.	Jo		

Shtojca 3. Komentet e Menaxhmentit të Komunës së Kaçanikut dhe përgjigjja e KPMG-së

Rekomandimet	Pajtohemi	Pajtohemi pjesërisht	Nuk pajtohemi	Komentet e Komunës	Komentet e KPMG-së
<p>Rekomandimi 1:</p> <p>Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet së Komuna do të ndërmarrë hapa për të përmirësuar sistemin e kontabilitetit dhe të faturimit në mënyrë që të sigurojë kontrole të sigurta, efiçiente dhe efektive në faturim dhe të hyra. Përmirësimi i procedurave të lidhura me këto sisteme do ti mundësonte menaxhmentit të monitoroj dhe menaxhojë rreziqet e mëdha dhe të sigurojë që vendimet në lidhje me buxhetimin, planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave janë bartur siç duhet. Ne i rekomandojmë komunës të konsideroj pikat si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Implementimin e një sistemi të faturimit që përfshin detaje të përditësuara për pagesit, adresën e tyre të tanishme, historinë dhe normën e mbledhjes së të hyrave nga këta pages. Qasje në informacion të tillë duhet të kenë vetëm një numër të limituar personash dhe të autorizuar nga menaxhmenti. 		X		<p>Komuna posedon lista te debitoreve sipas departamenteve, te cilat nuk jane te evidentuara ne excel, dhe jo ne ndonje program softuerik.</p> <p>Jane duke u bere perpjekje per instalimin e nje softueri gjithperfshires per ngarkesat ndaj debitoreve te Komunes per te gjitha drejtorite, dhe te behen barazimet me organizaten buxhetore.</p> <p>Komuna ka ngritur kete çështje në takimet e Kolegjiut të Drejtorëve për Buxhet dhe Financa.</p> <p>Eshte kerkuar nga ana e Asociacionit të Komunave të Kosovës për mbështetje financiare për një softuer unik në mënyrë që të tejkalohet kjo mangesi.</p>	<p>Komuna është pajtuar pjesërisht me gjetjet tona.</p>

Rekomandimet	Pajtohem	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem	Komentet e Komunës	Komentet e KPMG-së
<p>Rekomandimi 1 (vazhdim):</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të vendosë dhe të kontrollojë nga qendra tarifat dhe normat e taksave në sistem në mënyrë që të llogarisë dhe gjenerojë automatikisht faturat. Ky gjenerim i faturave gjithashtu duhet të autorizohet dhe të rishikohet. • Të ekzistojë një lidhje automatike në mes të sistemit të faturimit dhe sistemit të kontabilitetit në mënyrë që informacioni të procesohet automatikisht në librin kryesor të kontabilitetit. • Të lidhen automatikisht zyra e faturimit me operacionet dhe të bëhen barazime të rregullta në mes tyre, për rastet ku faturimi direkt lidhet me shërbimet nga zyra operacionale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur ekzekutohet një numër i madh i transaksionesh. 					

Rekomandimet	Pajtohemi	Pajtohemi pjesërisht	Nuk pajtohemi	Komentet e Komunës	Komentet e KPMG-së
<p>Rekomandimi 2: Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet që Komuna të ndërmarrë hapa të mëtijshme për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat dhe të jetë në pajtueshmëri të plotë me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve lokale.</p>				<p>Lidhur me procedurën e prokurimit KA652/11/21/521 i projektit Asfaltimi i rrugës Kaçanik-Gajre faza e I-rë në njoftimin për kontratë i kemi përcaktuar kriteret ” tenderi ekonomisht ma i favorshëm ” prandaj komisioni ju ka përmbajtur kritereve të përcaktuara dhe unë si menaxher e kam vlerësuar rekomandimin e komisionit. Natyra dhe kompleksiteti i këtij projekti e ka zgjatur planin dinamik, ju edhe në dokumentacion e keni pasur ditarin e punës. Unë si menaxher i ZP në kontratë e kam caktuar ingjinerin për mbykqyrjen e projektit për derisa nuk më ka njoftuar me shkrim për ngecjen e punëve apo tejkalimin e planit dinamik, unë nuk kam pasur arsye të marr ndonjë vendim tjetër.</p>	<p>Komuna është pajtuar pjesërisht me gjetjet tona. Gjetjet dhe rekomandimet tona janë bërë në bazë të dokumenteve të cilat na janë ofruar gjatë auditimit.</p>

Rekomandimet	Pajtohemi	Pajtohemi pjesërisht	Nuk pajtohemi	Komentet e Komunës	Komentet e KPMG-së
Rekomandimi 2 (vazhdim):				<p>Gjatë implementimit të projektit ka pasur pozicione kontestuese që dhe neve si AK na ka marrur kohë deri në zgjidhjen e kontesteve.</p> <p># Lidhur me procedurën e prokurimit KA652/11/06/521 i projektit: Asfaltimi i rrugës në fsh.Doganaj lagj,Mursel dhe Kolsh. Për realizimin e këtij projekti në kontr.nr.09/11 të dt-13.05.2011 vlera e kontratës është 129,980.76 euro, kurse janë të parapara me buxhetin e vitit 2011 në vlerë 50.000.00 euro të bëhet punë , kurse pjesa e punëve tjera të realizohen me buxhetin vitit 2012. Prandaj ky projekt ka qenë i pa përfunduar në vitin 2011 (vetëm faza e I-rë), ndërsa faza e II-të vazhdon në vitin 2012.</p>	

Rekomandimet	Pajtohemi	Pajtohemi pjesërisht	Nuk pajtohemi	Komentet e Komunës	Komentet e KPMG-së
Rekomandimi 2 (vazhdim):				<p># Lidhur me procedurën e prokurimit KA652/11/06/521 i projektit Asfaltimi i rrugës Dëshmorët e Lirisë - faza e II - të, është keni cekur lidhja e kontrates pa zotuar gjitha mjetet. Por unë po e konfirmoj se me dt.13.05.2011 kur e kam lidhur kontratën i kam pasur të gjitha mjetet e zotuar 50.000 euro + 10,926.26 euro me dt.05.05.2011 të zotuar., është e mundur që gjatë auditimit të lëndës mos ta keni vërejtur zotimin e II-të.</p> <p># Lidhur me procedurën e prokurimit KA652/11/052/521 i projektit "Meremetimi i pjesërisht në disa shkolla në Komunën e Kaçanikut", sa i përket afatit kohor që keni dhënë vërejtje është e qëndrueshme por mbikëqyrësi i projektit nuk më ka njoftuar me shkrim për mos përfilljen e planit dinamik.</p>	

Rekomandimet	Pajtohemi	Pajtohemi pjesërisht	Nuk pajtohemi	Komentet e Komunës	Komentet e KPMG-së
